



Kompensimi për personat paraplegjik dhe tetraplegjik nga autoritetet publike

Hyrje

Kushtetuta e Republikës së Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre¹. Të drejtat themelore të personave me aftësi të kufizuara, përveç me Kushtetutë, janë të garantuara edhe me shumë akte ndërkombëtare të cilat gjejnë zbatim në Kosovë, duke u ofruar atyre mbrojtje nga të gjitha llojet dhe format e diskriminimit.

Kosova në vitin 2016, ka miratuar Ligjin Nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, bashkë me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, ku është paraparë që ata të marrin kompensim të caktuar nga buxheti i Republikës së Kosovës. Në kuptimin e këtij ligji, "Paraplegjik" nënkupton çdo person, i cili si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor ka humbur në formë të përhershme mundësinë e lëvizjes së ekstremiteteve (gjymtyrëve) të poshtme, ndërsa 'Tetraplegjik' çdo person, i cili ka humbur në formë të përhershme mundësinë e lëvizjes së gjymtyrëve të poshtme dhe të epërme.

Përfituesit e këtij ligji mbrohen nga të gjitha llojet dhe format e diskriminimit, shfrytëzimit, abuzimit, fyerjes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të njohura nga Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut e me theks të veçantë me standardet dhe parimet e përcaktuara me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara². Ndër të tjera, sipas këtij ligji

¹ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3 (Barazia para Ligjit), pika 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702> (qasja e fundit më 9 janar, 2024).

² Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. Nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetra-

personave paraplegjik dhe tetraplegjik u njihet e drejta për një kujdestar personal, lirimit nga taksat dhe tatimi, përkujdesjes për strehim, kujdesit shëndetësor, arsimimit pa pagesë, reduktim në tarifa të shpenzimit të energjisë elektrike, si dhe udhëtim falas në trafikun urban.

Ndërkohë, Ligji për Paraplegjikët dhe Tetraplegjikët nuk përfshin një kategori njësoj të paaftë, Hemiplegjikët (Hemiplegjia – paralizë e pjesshme në gjysmën e majtë ose të djathtë të trupit). Kërkesat për trajtim në gjykatë nga ana e këtyre të fundit, janë të shumta dhe paraqesin sfidë për trajtim dhe gjykim të drejtë, pasi që nuk ka dispozita ligjore specifike që merren edhe me këtë kategori.

Komisioni vlerësues i përbërë prej ekspertëve mjekësor, i emëruar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), shqyrton kërkesat e përfituesve të këtij ligji, grupimin, statusin dhe përfitimet e tjera të garantuara me ligj.

Në rastet kur palët janë të pakënaqura me vendimet përfundimtare të këtij komisioni, zhvillohet procedurë gjyqësore përmes padive në Departamentin për Çështje Administrative që vepron në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe ka juridiksion për gjithë territorin e Kosovës. Kjo procedurë administrative gjyqësore është e rregulluar me Ligjin për Konfliktet Administrative. Sipas këtij ligji, konflikti administrativ mund të iniciohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. Po ashtu, konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative, nuk është lejuar ankesa³.

Ky është raporti i katërt me radhë, i cili përfshin dy raste të monitoruara lidhur me të drejtën për kompensim të personave paraplegjik dhe tetraplegjik. Qëllimi kryesor i këtij raporti të shkurtër, është që të kuptohet se si trajtohen këto lëndë në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Demokrati Plus (D+) i ka monitoruar dhjetë raste të shkeljeve administrative që nga maji i vitit 2023 dhe do të vazhdojë t'i mbulojë edhe dhjetë raste të tjera deri në maj të vitit 2025. Këto raporte të shkurtra të zgjedhura me metodë rastësore, adresojnë në mënyrë specifike monitorimin e të drejtës për kompensim në procedura administrative në kuadër të marrëdhënieve ndërmjet shtetit (administratës publike) dhe personave fizikë, duke përfshirë rastet e kompensimit për zyrtarët shtetërorë brenda administratës publike.

Një vështrim nga afër i dy rasteve ligjore që përfshijnë Paraplegjikët dhe Tetraplegjikët

Rastet e monitoruara janë zhvilluar rreth ligjshmërisë së akteve administrative (vendimeve përfundimtare të Komisionit të Ankesave të MFPT), pranë gjykatës themelore në procedurën e veçantë, e njohur si procedurë administrative gjyqësore. Shqyrtimet kryesore të këtyre çështjeve juridike u mbajtën konform nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është autoriteti publik i atakuar me padi në të dy rastet. Palët paditëse pretendojnë se me vendimet përfundimtare të organeve shtetërore, Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve dhe Komisionit të Ankesave në kuadër të MFPT, është shkelur ligji në dëm të tyre.

plegjik, neni 4: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12554> (qasja e fundit më 9 janar, 2024)

³ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, neni 13: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2707> (qasja e fundit më 9 janar, 2024).

Paditësit, në të dy rastet, kanë kërkuar njohjen e statusit të personave paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e parë. Sipas Rregullores për Përbërjen, Funkzionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përfituesit e grupit të parë janë persona me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve, ndërsa përfituesit e grupit të dytë janë persona që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve (...)⁴.

Në të dy rastet, personat paraplegjik dhe tetraplegjik, u janë nënshtruar procedurave të rivlerësimit sipas Rregullores. Ky rivlerësim bëhet çdo pesë vite, edhe pse këto raste janë sëmundje të përhershme.

Rasti 1

Padia e F.C. kundër vendimit të MFPT

Paditës: F.C. person fizik

E pandehur: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) – Departamenti i Pensioneve

Emri i gjyqtarit/es: Vjollca Limani

Data e seancës: 12.07.2023

Në këtë rast të monitoruar jepet një pasqyrë e procesit gjyqësor lidhur me një padi, kërkesë për kompensim e iniciuar nga F.C., person paraplegjik dhe tetraplegjik, kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) – Departamenti i Pensioneve. Paditësi ka kërkuar nga gjykata që të miratojë kërkesën për njohjen e të drejtës së pensionit për personat paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e parë, caktimin e kujdestarit personal, si dhe kompensimin në mënyrë retroaktive që nga koha e paraqitjes së kërkesës.

Kërkesa për kompensim, paditësit F.C., fillimisht iu kishte refuzuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në vitin 2020. Po ashtu, kjo kërkesë iu kishte refuzuar edhe nga organi i dytë, Këshilli i Ankesave pranë kësaj ministrie. Prandaj në janar të vitit 2021, pala paditëse vazhdoi që të ndjekë rrugën ligjore duke nisur padi në gjykatë.

Radha që kjo padi të shqyrtohej në seancë, erdhi pas dy viteve. Më 25 prill 2023 është mbajtur seanca e parë dëgjimore, e cila u pasua edhe nga dy seanca të tjera. Është e rëndësishme të theksohet se në mungesë të një avokati, pala paditëse përfaqësohej nga prindi S.C., gjatë gjithë procesit gjyqësor.

Nga ana tjetër, e paditura, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, e cila kishte munguar në të tri seancat gjyqësore, në përgjigjen me shkrim për gjykatën e kishte kontestuar në tërësi këtë padi. Megjithatë Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka ofruar mbështetje për palën paditëse në

⁴ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës. Rregullore (QRK) nr. 07/2017 për përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë e komisionit vlerësues dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, e miratuar në mbledhjen e 146 - të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin nr.02/146 të dt.26.05.2017, <https://gzk.rks-gov.net/Act-Detail.aspx?ActID=15161>, (qasja e fundit më 10 janar, 2024).

këtë proces ligjor, ata nuk qenë të pranishëm në sallë për të ofruar përfaqësim ligjor për palën paditëse gjatë seancave dëgjimore.

Gjatë këtyre seancave, gjykata kishte vërejtur se vendimi i kontestuar përmbante të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohej ligjshmëria e tyre. Po ashtu, gjykata kishte vlerësuar si provë edhe vlerësimet e Komisionit Mjekësor të të paditurës, mirëpo meqë në to nuk ishin dhënë sqarime dhe arsyetime lidhur me refuzimin e kërkesës së paditësit, atëherë gjykata aprovi propozimin e përfaqësuesit ligjor të paditësit F.C. për nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore të caktuar nga ana e gjykatës. Kjo me qëllim që të arrihej një konstatim i drejtë i gjendjes faktike.

Në këtë rast, ekspertët mjekësorë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës pas punimit të ekspertizës së tyre, kishin ardhur në përfundim se pacientja F.C. i takon grupit të parë të kategorisë së personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi kujdestar. Këtë konstatim, të tre mjekët e mbështetën edhe në seancën e fundit të datës 12.07.2023.

Konkluzion: Lidhur me këtë rast, Gjykata Themelore me Aktgjykimin e datës 20.07.2023 vendosi në favor të paditësit F.C., duke ia njohur të drejtën për kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e parë, së bashku me kujdestarin personal, në kohëzgjatje prej 5 vitesh nga data e ekzaminimit mjekësor.⁵ Në arsyetimin e këtij aktgjykimi thuhet se vendimi i MFPT-së ka shkelur dispozitat e ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, veçanërisht nenin 48, si dhe përmban të meta të tilla që e vënë në dyshim ligjshmërinë e tij. Vendimi i shkallës së dytë (Komisionit të Ankesave – MFPT) është juridikisht i paqartë dhe kontradiktor me arsyetimin e tij, thuhet ndër të tjera në këtë aktgjykim. Gjykata më tej pohon se në arsyetimin e këtij vendimi është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt, si dhe nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar.

Rasti 2

Padia e I.T. kundër MFPT

Paditës: I.T. person fizik

E pandehur: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) – Departamenti i Pensioneve

Emri i gjyqtarit/es: Kreshnik Kaçiu

Data e seancës: 20.11.2023

Njësoj sikurse në rastin e parë, paditësi I.T. ka kërkuar nga gjykata anulimin e vendimit nga organi i shkallës së dytë, përkatësisht Komisioni i Ankesave pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Paditësi I.T. ka pohuar se ky organ ka bërë shkelje të ligjit dhe rregullores në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik duke mos ia aprovuar kërkesën në grupin e parë.

⁵ Vendimi i Gjykatës Themelore, A.nr.198/21, datë: 20.07.2023

Fillimisht, paditësi I.T. kishte aplikuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në departamentin përkatës, për njohje të së drejtës në pension për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik në grupin e parë. Mirëpo kërkesa iu refuzua nga ky organ. Me vendimin e datës 07.12.2022 kjo kërkesë iu refuzua edhe nga organi i shkallës së dytë, Komisioni i Ankesave. Vetëm pas kësaj, paditësi ngriti padi në gjykatë kundër këtij organi publik.

Padia ishte inicuar në janar të vitit 2023 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ndërsa radha që të shqyrtohej në seancë i kishte ardhur me datë 20.11.2023. Për dallim nga rastet e tjera të cilat zgjasin me vite deri në shqyrtim, ky është një ndër rastet e rralla, ku lënda arrin të trajtohet brenda vitit që nga deponimi i saj në gjykatë.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit theksoi se vendimi i të paditurës është i kundërligjshëm, nuk përkon me provat materiale, si dhe është në kundërshtim me gjendjen faktike shëndetësore të paditësit, andaj nga gjykata ka kërkuar që të anulohet këtij vendim apo ta kthejë çështjen në rivendosje në organin kompetent administrativ.

Në anën tjetër, nga e paditura Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, askush nuk mori pjesë në seancë. Megjithatë në përgjigjen e tyre në padi të datës 30.06.2023, ky organ e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit si të pabazuar duke pohuar se vendimi i atakuar është marrë konform ligjit.

Konkluzion: Lidhur me këtë rast, Gjykata Themelore me Aktgjykimin e datës 20.12.2023 vendosi që të anulohet vendimin e MFPT, si dhe çështja të rikthehet për rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura⁶. Në këtë aktgjykim, gjykata theksoi se vendimi i atakuar përmban shkelje të dispozitave thelbësore të Ligjit për Procedurën Administrative⁷, Rregullores për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik⁸, si dhe të meta të tjera që pengojnë shqyrtimin e ligjshmërisë së këtij akti. Tutje, gjykata pohon se vendimi i kontestuar duhet të përmbajë një përmbledhje të konstatimeve faktike, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti administrativ, akti duhet të jetë i arsyetuar etj.

Andaj, me këtë aktgjykim, gjykata ka obliguar organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Po ashtu, gjykata ka theksuar se vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

⁶ Vendimi i Gjykatës Themelore, A.nr 131/2023, datë: 20.12.2023

⁷ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. Nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, neni 8: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12554> (qasja e fundit më 10 janar, 2024)

⁸ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës. Rregullore (QRK) nr. 07/2017 për përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë e komisionit vlerësues dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, neni 5 paragrafi 1.2 dhe 1.3 dhe neni 6, paragrafi 1.2 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15702> (qasja e fundit më 10 janar, 2024).

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Ligji për Paraplegjikët dhe Tetraplegjikët, përjashton një kategori njësoj të paaftë – Hemiplegjikët. Trajtimi dhe gjykimi i drejtë i këtyre rasteve paraqet sfidë për gjyqtarët, pasi që nuk ka dispozita ligjore specifike që merren edhe me këtë kategori. Rekomandohet që të bëhet plotësimi i këtij ligji, duke përfshirë edhe personat Hemiplegjikë.
- Rekomandohet që Rregullorja Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin dhe Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues, e cila parashikon rivlerësimin periodik të individëve me paraplegji dhe tetraplegji çdo pesë vjet, të ndryshohet, duke marrë parasysh natyrën kronike të këtyre gjendjeve.
- Në të dy rastet e monitoruara, gjykata kishte gjetur të meta dhe shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative në aktvendimet e organit të shkallës së dytë, Komisionit të Ankesave pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Aktvendimet e këtij organi publik kane qenë juridikisht të paqarta dhe kundërthënëse me veten. Rekomandohet që organet e shkallës së dytë të nxjerrin vendime në përputhje me Ligjin për Procedurat Administrative, në mënyrë që gjykatave të mos u krijohet barrë në trajtimin e lëndëve.
- Në mungesë të një përfaqësimi ligjor të palëve paditëse gjatë seancave gjyqësore, si përfaqësues ligjor kishte vepruar prindi i paditësit në rastin e parë, ndërsa në rastin e dytë paditësi përfaqësoi veten. Megjithëse Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ofron mbështetje të vlefshme për qytetarët, kërkesa për përfaqësim ligjor gjatë seancave dëgjimore është shumë e nevojshme për paraplegjikët dhe tetraplegjikët. Prandaj këshillohet që institucionet shtetërore të rrisin shërbimet e Ndihmës Juridike, duke ofruar përfaqësim ligjor gjatë seancave gjyqësore për personat që nuk mund të përballojnë një përfaqësim të tillë, posaqërisht për personat e kategorive të ndjeshme të shoqërisë.

